


për AFERDIEN M.
prower: *[Signature]*
06.06.2017



Prizren Institute for the Protection of Monuments
8414
06.06.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	01.06.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 84/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë



Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.39/2017 të dt. 22.05.2017 për lëndën Todor Radiqi nr.04-353/01-25948 për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 03698-0

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



272

31.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 39/2017

Datë: 22.05.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi i Projektit Ideor për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 03698 – 0 Z.K. Prizren".
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Kjo kërkesë, e palës Todor Radiqi nga Prizreni, është drejtuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor e Komunës së Prizrenit në QRTK-Prizren, më 14.04.2017 dhe pastaj më datë 28.04.2017 është pranuar dhe protokoluuar në IKMM, me nr.protokoli 193/2017.

Todor Radiqi nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e objektit-shtëpi individuale për banim, etazhiteti P+1, në ngastrën kadastrale 03698-0, dhe në rrugën "R. Nojica", nr.34. Objekti që do të ndërtohet gjendet në zonën e VII-të (Zona e banimit - Struktura organike), sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është P+1 (lartësia maksimale deri te streha është 6.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 50% e sipërfaqës së parcelës. Në parcelë të lartëcekur nuk ka ndonjë ndërtesë ekzistuese, përveç rrënojave të objekteve të mëhershme, respektivisht vendi është i mbushur me mbeturina. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjenden kisha e Shën Gjergjit që është në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017).

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës si dhe të projektit ideor aprovon projektin, i cili është në përputhshmëri me parametrat e caktuara me Plan të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit. Rekomandohet që ngjyra e ndërtesës të përcaktohet në bazë të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit në bashkëpunim me QRTK Prizren.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Të aprovohet Projekti Ideor për ndërtimin e objektit - shtëpi individuale për banim, etazhiteti P+1 numri i parcelës 03698-0, i cili i përmbush kriteret për ndërtime të reja në zonën e VII-të (Zona e Banimit - Struktura Organike) sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Ngjyra e ndërtesës të përcaktohet në bazë të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit në bashkëpunim me QRTK Prizren.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM -së;
- Arkivit të IKMM -së;
- Arkivit të MKRS – së;

